



Pranimi / Datozuar Primenje / Predato Received / Delivered	04.05.2022	2 viti god year	
Organ / Agjencia Organ / Jednica Org. Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMBHUK	2585/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.281/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.281/2022 të datës 24.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër Vendimit me numër protokoli 935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Pezullohet procedura administrative lidhur me ankesën A.nr.281/2022 të datës 24.03.2022 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, përmes emailit më datë 23.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokoli 935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ( tutje AZHB), ndërsa kjo e fundit më datë 06.04.2022 ka dorëzuar shkresat e lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll: 1561/2022 të datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 5538 të datës 30.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Vendimin me numër protokoll 935 i datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Emailin e datës 23.03.2022 të ankueses; Plotësimin e ankesës nga ana e ankueses e datës 25.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 06.04.2022; Akt Emërimit me numër protokoll 17 i datës 04.01.2013; Vendimin me numër protokoll 4998 i datës 21.07.2021 për pezullim nga puna i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Shkresën për shqyrtimin e kërkesës me numër protokoll 5483 e datës 23.08.2021; Emailin e datës 23.08.2021; Emailin e datës 23.08.2021 na Emailin e datës 22.08.2021 nga Emailin e datës 16.08.2021 nga Njoftim i datës 15.07.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Procesverbalin e datës 30.08.2021 me numër protokoll 5535 i Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 25.02.2022 nga Emailin e datës 24.02.2022 nga Emailin nga lidhur me opinionin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Emailin e datës 25.01.2022 nga Kërkesën për informata zyrtar e datës 20.04.2022 për Administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Përgjigjen e datës 20.04.2022 nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore që ankesa e ankueses të pezullohet, *sepe*:

Nga administrimit i provave materiale rezulton së ankuesja në bazë të Akt Emërimit me numër protokoll 17 të datës 04.01.2013 është e punësuar në pozitën *Zyrtare e Lartë për Pagesa Direkte në Blegtori* në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

Bazuar në shkresën me nr.dokumenti 01433698 të datës 15.07.2021 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, Zëvendësuesi Kryeshefit Ekzekutiv të AZHR-së me Vendimin me numër protokoll 4998 të datës 21.07.2021 ka pezulluar nga puna ankuesen për arsye se ndaj ankueses me datë 30.06.2021 është caktuar masa e paraburgimit me dyshimin se e njëjta ka kryer vepër penale nga nenin 414 dhe 419 të Kodit Penal.

Më datë 23.08.2021 Menaxherja e Personelit ka përcjell pranë Komisionit Disiplinor të AZHB-së kërkesën e datës 23.08.2021 të Udhëheqësit të drejtpërdrejt të ankueses për inicim të procedurës disiplinore ndaj të njëjtës. Ky i fundit me Vendimin Ref.07/04/130/2021 të datës 30.08.2021 respektivisht në pikën 1 nën-pikën 1.4 të dispozitiv të këtij vendimi ka bërë pezullimin e ankueses nga marrëdhënia e punës deri në një vendim tjetër, me kompensim të 50% të pagës. Pas opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të datës 24.02.2022, Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër protokoll 935 të datës 28.02.2022, ka ndryshuar pikën tre (3) të Vendimit Ref.07/04/130/2021 të datës 30.08.2021, ashtu që ankueses i është ndërprerë pagesa e 50 % e pagës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në plotësimin e ankesës më datë 25.03.2022, pretendon se Ligji për Zyrtarët

Publikë nuk jep ndonjë sqarim të detajuar lidhur me masën e pezullimit sepse nuk përcaktohet që vetëm për gjashtë muaj duhet t'i bëhet kompensimi i 50% të pagës, po ashtu meqenëse jam ende në procedurë gjyqësore dhe përderisa nuk ka vendim përfundimtar nuk mund të më ndalohej kompensimi i 50% të pagës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për të vendosur në mënyrë meritore, më datë 20.04.2022 ka kërkuar informata nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me çështjen penale të ankueses, ndërsa ky i fundit përmes emailit të datës 20.04.2021 i protokolluar me numër 2284/2022 ka njoftuar Këshillin se: *ankuesja në cilësi të pandehurës pas arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë me PSRK-në, me datë 19.04.2022 me Aktgjykimin e Gjykatës është shpallur fajtor dhe gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim do të filloj ta mbaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro, të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe së bazë të nenit 59 par.2 nënpar.2.3 të KPRK-së të akuzuarës gjykata i ka shqiptuar dënim plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë publike në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim. Me tej shton se aktgjykimin në formë të shkruar do të behet një muaj nga data e shpalljes së tij*”.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh së Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar se ankuesja është shpallur fajtorë për kryerje të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar sipas nenit 414 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe meqenëse ky aktgjykim ende nuk është hartuar dhe dorëzuar palëve, Kolegji vlerëson së për shkak të rrethanave të tilla nuk është i mundur shqyrtimi dhe vendosja lidhur me ankesën A.nr.281/2022, kështu që në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,* Kolegji konstaton që ankesa A.nr.281/2022 të pezullohet deri në plotfuqishmërinë e vendimit të gjykatës lidhur me çështjen penale të ankueses.

Duke u bazuar si me lartë, dhe në mbështetje të nenit nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

#### Këshillë juridike:

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.281/2022

Avdyll BEKTESHI

*Avdyll Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

